



Financed from EWBIF by a contribution from the EU IPA Multi-Beneficiary Programme for Albania, Bosnia and Herzegovina, the former Yugoslav Republic of Macedonia, Kosovo\*, Montenegro and Serbia

# **Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor Instrumenti Lehtësues për Projektet e Infrastrukturës (IPF) Asistenca Teknike 4 (IPF 4)**

WB11-ALB-ENE-01

## **Master Plani i Gazit Natyror për Shqipërinë dhe Identifikimi i Projekteve Prioritare në Fushën e Gazit Natyror**

### **Vleresimi Strategjik Mjedisor Draft Raport Paraprak Permbledhje jo-teknike**

Mars 2016



*Fondi i përbashkët European për vendet e Ballkanit  
Perëndimor (EWBJF)*

## **Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor**

### **Instrumenti Lehtësues për Projektet e Infrastrukturës (IPF)**

#### **Asistenca Teknike Nr 4**

### **Sektorët e Energjisë, Mjedisit, Transportit dhe Infrastrukturës Sociale**

WB11-ALB-ENE-01

Master Plani i Gazit për Shqipërinë dhe

Projektet Prioritare të Investimeve në fushën e Gazit

Vlerësimi Strategjik Mjedisor

Draft Raport Paraprak

#### **Permbledhje jo-teknike**

Mars 2016

*Assistenca Teknike për këtë projekt financohet nga Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor që është një iniciativë e përbashkët e Komunitetit European, Institucioneve Financiare Ndërkombëtare, dhuruesve dypalësh dhe qeverive të Ballkanit Perëndimor, të cilat mbështesin zhvillimet socio-ekonomike dhe tratativat për pranimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin European nëpërmjet sigurimit të fondeve dhe asistencës teknike për investime strategjike veçanërisht në infrastrukturë, efikasitetin e energjisë dhe zhvillimin e sektorit privat.*

**Shënim:** Autorët marrin përgjegjësi të plotë për përmbajtjen e këtij raporti. Mendimet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit European ose Bankës Europiane të Investimeve

Document nr. WB11-ALB-ENE-01 VSM / Draft Raport Paraprak / Permbledhje jo - teknike  
Versioni 1.0  
Data e lëshimit Mars 2016  
Përgatiti Ardian Shehu  
Kontrolloi Ole Johansen  
Aprovoi Martyn Osborn



# Përmbajtja

1	Hyrje	1
1.1	Sinopsis	1
1.2	Qëllimi i Draft Raportit Paraprak të Vlerësimit Strategjik Mjedisor mbi Master Planin e Gazit për Shqipërinë	1
2	Master Planit i Gazit për Shqipërinë	3
2.1.1	Konteksti i Hartimit të Master Planit të Gazit	3
2.1.2	Qëllimi i Hartimit të Master Planit të Gazit	3
2.1.3	Paraqitje e përmbledhur e MPG	4
2.1.4	Zona e prekur nga MPG	4
3	Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Master Plani i Gazit për Shqipërinë	7
3.1	Përse duhet kryer VSM mbi MPG	7
3.2	Cështjet që duhen njohur për të arritur synimet e VSM mbi MPG	8
3.3	Baza ligjore ku mbështetet VSM mbi MPG	8
3.4	Metodologjia e procesit të VSM për MPG	9
3.4.1	Qasja e ndjekur në rastin e VSM për MPG	9
3.4.2	Fazat e VSM për MPG	10
3.4.3	Qëllimi i përgatitjes së raportit paraprak dhe konsultimit të tij	10
3.4.4	Detyrat e fazës paraprake të VSM mbi MPG	11
3.4.5	Përcaktimi i çështjeve mjedisore the objektiveve përkatëse të VSM mbi MPG	12
3.4.6	Testimi i objektiveve të VSM dhe atyre të MPG dhe vlerësimi i alternativave të MPG.	12
3.4.7	Konsultimi i draft raportit paraprak të VSM	13
3.4.8	Hartimi i draft raportit përfundimtar të VSM	14
3.4.9	Planifikimi i konsultimeve mbi draft raportin përfundimtar të VSM dhe draft raportin e MPG	14
4	Literatura	16

## Shkurtime

BE - EU	Bashkimi Europian – European Union
BEI - EIB	Banka Europiane e Investimeve - European Investment Bank
BERZH -	Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim – European
EBRD	Bank for Reconstruction and Development
DSO	Operatori i Sistemit te Shperndarjes - Distribution System Operator
BEI - EIB	Banka Europiane e Investimeve - European Investment Bank
ERE	Enti Rregullator i Energjisw
SF - FS	Studim Fizibiliteti - Feasibility Study
IAP	Gazsjellesi Jonian-Adriatik - Ionian-Adriatic Pipeline
IFN - IFI	Institucionet Financiare Nderkombetare - International Financial Institutions
ILPI- IPF	Instrumenti Lehtësues për Projektet e Infrastrukturës - Infrastructure Project Facility
RF- IR	Raporti Fillestar (Raporti mbi ceshtjet kryesore qe duhet te trajtoje nje Plan/Projekt/Program) - Inception Report
PIP-PIP	Plani i Identifikimi te Projekteve - Project Identification Plan
KE - EC	Kommisioni Europian – European Commission
LNG	Gaz Natyror i Lengezuar – Liquefied Natural Gas
LPG	Gas propan i lengezuar - Liquefied Petroleum Gas
FS	Studim Fizibiliteti - Feasibility Study
MPG_GMP	Master Plani i Gazit – Gas Master Plan
OST-G	Operatori i Sistemit tw Transmetimit të Gazit (OST-G)
PIP	Projekte ne Interes te Perbashket
PMS-EPS	Politikat Mjedisore e Sociale – Environmental and Social Policy
PR	Project Requirements - Kerkesat e Projektit
PS	Furnizues Publik - Public Supplier
TAP	Trans-Adriatic Pipeline
ToR	Termt e References - Terms of Reference
TSO	Operatori i Sistemit te Transmetimit - Transmission System Operator
VKM-CDM	Vendim i Keshillit te Ministrave – Council of Ministers Decision
VNM-EIA	Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis – Environmental Impact Assessment
VNMS-ESIA	Vleresimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social- Environmental and Social Impact Assessment
VSM - SEA	Vleresimi Strategjik Mjedisor – Strategic Environmental Assessment
ZM-PA	Zone e mbrojtur – Protected Area

## Lista e Tabelave

Table 3-1_ Çështjet e VSM-së dhe objektivat mjedisore në rastin e MPG për Shqipërinë	12
Table 3-2_ Alternativat e propozuara në lidhje me MPG	13
Table 3-3_ Testimi i përputhshmërisë të objektiveve të VSM-së dhe MPG	13

## Lista e Figurave

Figure 1—1_ Qëndrat urbane dhe korridorret e mundshme të gazit sipas MPG	5
Figure 1—2_ Paraqitje skematike e pozicionit të tubacioneve egzistuese të gazit e naftës si dhe vendeve të mundshme nëntokësore të gazit	6



## Terma spjegues shqip-anglisht

<p>VKM 219/2015;  CMD 219/2015</p>	<p>-Vendim i Këshillit të Ministrave nr 219, datë 11.03.2015: “Për përcaktimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për informimin, përfshirjen dhe konsultimin me publikun dhe grupet e interesit gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”;</p> <p>-Council of Ministers Decision No 219, of November 03.2015, “On the rules and procedures for consultation with public and stakeholders, and public consultations during the strategic environmental assessment process”</p>
<p>VKM 507/2015;  CMD 507/2015</p>	<p>-Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 507, datë 10.06.2015: “Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”;</p> <p>-Council of Ministers Decision no 507, of June 06.2015: “On the approval of the detailed list of plans and programs with significant negative environmental effects, which shall be submitted to the SEA process”</p>
<p>VKM 620/2015;  CMD 620/2015</p>	<p>-Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 620, datë 07.07.2015: “Për miratimin e rregullave, përgjegjësive dhe procedurave të detajuara për vlerësimin strategjik mjedisor në kontekstin ndërkufitar;</p> <p>-Council of ministers decision no 620, of July 07.2015: “On approval of the rules, responsibilities and detailed procedures on strategic environmental assessment in a trans boundary context”</p>
<p>TKE;  ECT</p>	<p>-Traktati i Komunitetit të Energjisë (Vendimi 2006/500 i Këshillit të Europës me 26 Maj 2006), i cili synon krijimin e një tregu të njehsuar të tregut të energjisë (energji elektrike dhe gaz) midis BE dhe 6 vendeve të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje, Kosove, Mali i Zi, Maqedoni, Serbi);</p> <p>-The Energy Community Treaty (Council Decision 2006/500/EC of 29 May 2006) provides for the creation of an integrated energy market (electricity and gas) between the EU and 6 European states and territories in the Balkans.</p>
<p>Direktiva mbi VNM;  EIA Directive</p>	<p>-Direktiva 2014/52/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 16 prill 2014: "Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin";</p> <p>-Directive 2014/52/EU of the European Parliament and of the Council of 16 April 2014 amending Directive 2011/92/EU: “On the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment”</p>

<p>Konventa Espoo;</p> <p>Espoo Convention</p>	<p>-Konventa për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkuftar (25 shkurt 1991, Espoo, Finlande). Kjo Konventë rregullon detyrimet e vendeve firmëtare mbi vlerësimin e ndikimeve mjedisore në fazën e planifikimit të projektit. Konventa rregullon edhe detyrimet e vendeve firmëtare mbi konsultimet e ndersjellta mbi projektet që mund të kenë ndikime tëndjeshme në mjedisin ndërkuftar.</p> <p>-Adopted in 1991 and entered into force in 1997, the Espoo (EIA) Convention sets out the obligations of Parties to assess the environmental impact of certain activities at an early stage of planning. It also lays down the general obligation of States to notify and consult each other on all major projects under consideration that are likely to have a significant adverse environmental impact across boundaries.</p>
<p>Konventa UNECE (Konventa Aarhus);</p> <p>UNECE Convention</p>	<p>-Konventa e UNECE mbi të drejtën për informacion, Pjesëmarrjen Publike në Vendimmarrje dhe Të drejtën për t'ju drejtuar Gjykatës në Çështje Mjedisore (Konventa Aarhus), miratuar në qershor 1998, në Aarhus, në Danimarkë.</p> <p>-Convention on Access to Information, Public Participation in Decision-making and Access to Justice in Environmental Matters (June 1998, Aarhus, Denmark). The Convention grants the public rights and imposes on Parties and public authorities obligations regarding access to information and public participation and access to justice</p>
<p>Direktiva mbi Habitatet;</p> <p>Habitats Directive</p>	<p>-Direktiva 93/43/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 22 maj 1992: "Për ruajtjen e habitateve natyrore, të faunës dhe florës së egër". Direktiva synon mbrojtjen e larmisë biologjike duke marrë në konsideratë edhe zhvillimet ekonomike, sociale kulturore. Direktiva synon krijimin e nje rrjeti zonash të mbrojtura (special areas of conservation), të cilat, se bashku me rrjetin e zonave të mbrojtura egzistuese, formojnë një rrjet zonash të mbrojtura, të quajtur Natura 2000; Ligji nr.9587, datë 20.07.2006: "Për mbrojtjen e biodiversitetit "përputhet plotësisht me këtë Direktivë.</p> <p>-Directive 92/43/EU of the European Parliament and of the Council of 22 May 1992: "On the Conservation of natural habitats and of wild fauna and flora". The Directive aims to promote the maintenance of biodiversity, taking account of economic, social, cultural and regional requirements. It led to the setting up of a network of Special Areas of Conservation, which together with the existing Special Protection Areas form a network of protected sites across the European Union called Natura 2000.</p>
<p>Kuadri i Investimeve të</p>	<p>-Nismë e përbashkët e Komunitetit Europian, Institucioneve Financiare Ndërkombëtare, dhuruesve dypalësh dhe qeverive të Ballkanit Perëndimor, të cilat mbështesin zhvillimet socio-ekonomike dhe tratativat për pranimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian nëpërmjet sigurimit të</p>

Ballkanit Perëndimor  (Western Balkans Infrastructure Facility - WBIF)	<p>fondeve dhe asistences teknike për investime strategjike veçanërisht në infrastrukturë, eficensën e energjisë dhe zhvillimin e sektorit privat.</p> <p>-A joint initiative of the EU, International Financial institutions, bilateral donors and the governments of the Western Balkans which supports socio-economic development and EU accession across the Western Balkans through the provision of finance and technical assistance for strategic investments, particularly in infrastructure, energy efficiency and private sector development.</p>
Ligji mbi VSM;  Law on SEA (SEA Law)	<p>-Ligji Nr. 91, i miratuar nga Parlamenti i Shqipërisë, datë 28 shkurt 2013: "Mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor". Ky Ligj është në përputhje të plotë me Direktivën mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor;</p> <p>-Law no 91, of the Albanian Parliament, of February 28. 2013: "On Strategic Environmental Assessment". Law is in full compliance with the EU SEA Directive</p>
Ligji mbi VNM;  Law on EIA (EIA Law)	<p>-Ligji Nr. 10440, miratuar nga Parlamenti i Shqipërisë është datë 07 korrik 2011: "Mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis". Ky Ligj është në përputhje të plotë me Direktivën mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Direktiva mbi VNM);</p> <p>-Law no 10440, of the Albanian Parliament, of July 07. 2011: "On Environmental Impact Assessment". Law is in full compliance with the EU EIA Directive</p>
Perjashtimet nga procesi i VSM	Prescreening
Protokolli i Kievit;  Kiev Protocol	<p>-Protokoll mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor (Kiev, Ukraine, Maj, 2003).sipas të cilit shtetet firmëtare duhet të vlerësojnë ndikimet mjedisore të draft planeve/programëve të hartuara prej tyre;</p> <p>Protocol on the Strategic Environmental Assessment (Kiev, Ukraine, May 2003), which requires its signatory Parties to evaluate the environmental consequences of their official draft plans and programmes.</p>
Raporti fillestar	Inception Report
Raporti mbi Qëndrimin ndaj nevojës për VSM	<p>-Eshtë raporti mbi bazën e të cilit gjykohet në se një plan/program duhet të nënshtrohet ose jo procesit të VSM;</p> <p>-SEA Screening Report</p>
Raporti perfundimtar i VSM	<p>-Eshtë Raporti përfundimtar i VSM, mbi bazën e të cilit gjykohet për miratimin ose jo të VSM;</p> <p>-SEA Environmental Report.</p>

<p>VSM  SEA</p>	<p>-Vlerësimi Strategjik Mjedisor është vlerësimi i ndikimeve të mundshme të vënies në jetë të një plani/programi, para se të merret vendimi për adoptimin e tij. Produkti kryesor i këtij vlerësimi është Raporti përfundimtar i VSM, mbi bazën e të cilit gjykohet për miratimin ose jo të VSM;</p> <p>-Strategic Environmental Assessment is the evaluation of the likely significant environmental effects of implementing a plan/program before a decision is made to adopt it. The output of the SEA is the SEA Environmental report, based on which the related authorities should approve the SEA.</p>
<p>Direktiva mbi VSM;  SEA Directive</p>	<p>-Direktiva 2001/42/KE e Parlamentit European dhe Këshillit, datë 27 qershor 2001: “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara”;</p> <p>-Directive 2001/42/EC of the European Parliament and of the Council of 27 June 2001: “On the assessment of the effects of certain plans and programs on the environment”</p>
<p>Qëndrimi ndaj nevojës për VSM;  SEA Screening</p>	<p>-Është procesi, mbi bazën e të cilit vendoset në se një plan/program duhet ti nënshtrohet ose jo procesit të VSM. Vendimi merret nga Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me autoritete të tjera, të përcaktuara me ligj. Produkti i kësaj faze është raporti i qëndrimit ndaj nevojës për VSM;</p> <p>-SEA Screening is the process of determining whether a plan/program should be submitted or not to a Strategic Environmental Assessment process. This determination is the task of the Ministry of Environment and other potential relevant environmental authorities. The output of Screening is the SEA screening report.</p>
<p>Faza paraprahe e VSM;  SEA Scoping</p>	<p>-Është procesi i përcaktimit të metodologjisë, çështjeve që do të trajtohen, si dhe nivelit të hollësive të informacionit që do të jepet në raportin përfundimtar të VSM. Qëllimi dhe niveli i informacionit vendosen nga bashkëpunimi midis zhvilluesit të projektit dhe vendimmarrësve kryesorë, të cilët caktohen nga ligji. Produkti i këtij procesi është raporti paraparak i VSM (SEA Scoping report).</p> <p>-Scoping is the process of determining the methodology, the issues, as well as the level of details of the information to be addressed in the SEA Environmental report. The scope and the level of detail of the information to be included in the environmental report are determined in collaboration with the relevant environmental authorities. The output of Scoping is the SEA Scoping report</p>

# 1 Hyrje

## 1.1 Sinopsis

Titulli i Projektit:	Master Plani i Gazit për Shqipërinë dhe Identifikimi i Projekteve Prioritare në fushën e Gazit
Kodi i Projektit:	WB11-ALB-ENE-01
Kontraktori:	COWI IPF Consortium
Përfituesit:	Ministria e Energjisë dhe Industrisë (përfituesi kryesor), Albpetrol dhe ERE
Data e fillimit të Projektit:	02 Qershor 2015
Kohëzgjatja e parashikuar:	16.5 muaj
Data e parashikuar e mbarimit :	Dhjetor 2016

## 1.2 Qëllimi i Draft Raportit Paraparak të Vlerësimit Strategjik Mjedisor mbi Master Planin e Gazit për Shqipërinë

Konsortiumi COWI-IPF (që më tej referohet si "Konsulenti") është kontraktuar nga Ministria e Energjetikes dhe Industrisë (MEI) për të përgatitur Master Planin e Gazit për Shqipërinë (MPG) dhe Planin e Identifikimit të Projekteve prioritare (PIP) që synon zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të gazit natyror që do të sjellë një kontribut të konsiderueshëm në sistemin e energjisë, sigurinë e furnizimit me gaz natyror, në konkurrencën dhe mbrojtjen e mjedisit.

Puna për përgatitjen e MPG dhe PIP filloi në qershor 2015. Në korrik 2015, MEI kërkoi që Konsulenti COWI-IPF të kryejë edhe studimin mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) në të njëjtën kohë me hartimin e MPG.

Studimi i VSM është detyrim ligjor dhe duhet të përmbushë kërkesat legjislativitetit shqiptar dhe atij evropian. Gjithashtu, procesi i VSM duhet të jetë në përputhje edhe me standartet e BERZH, si financuesi kryesor i mundshëm i zbatimit të MPG, si dhe të BEI, si autoriteti kontraktues i grantit për realizimin e këtij studimi

Në Janar 2016, konsulenti COWI-IPF përfundoi raportin mbi qëndrimin ndaj nevojës për VSM. Bazuar në këtë raport dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, në shkurt 2016, Ministria e Mjedisit vendosi që MPG për Shqipërinë duhet ti nënshtrohet procesit të VSM, pjesë e të cilit është edhe ky raport paraprak.

Ky dokument përcakton çështjet mjedisore e sociale që duhen marrë në konsideratë, si dhe nivelin e vlerësimit dhe informacionit që duhet përfshirë në raportin përfundimtar të VSM mbi MPG. Procedura e ndjekur në fazën paraprake ndihmon aktorët kryesore ligjore, grupet e interesit si dhe publikun për të kuptuar më mirë MPG dhe efektet e mundshme mjedisore të tij. Faza paraprake gjithashtu ndihmon zhvilluesin e MPG të marrë në konsideratë dhe të trajtojë me korrektësi e profesionalizëm çështjet mjedisore që në fazat e hershme të zhvillimit të Planit.

Faza paraprake e VSM kërkohet formalisht si nga legjislacioni shqiptar, ashtu edhe ai i BE-së. Ndërsa raporti paraprak kërkohet formalisht vetëm nga ligji shqiptar mbi VSM (Neni 7 (c)), sepse Direktiva e BE mbi VSM nuk kërkon në mënyrë taksative hartimin e tij. Megjithatë, përgatitja e këtij raporti këshillohet fuqimisht si një mënyrë e përshtatshme për të përshkruar hapat procedurale që do të ndiqen si pjesë e procesit të VSM, si dhe për të paraqitur informacionin e duhur mjedisor.

Ky draft raport paraprak është variant i përkohshëm i raportit paraprak të VSM, sepse varianti përfundimtar do të përgatitet pas konsultimit formal të tij (Ligji mbi VNM, Neni 10(3)).

Kjo përmbledhje jo-teknike është detyrim ligjor (ligji mbi VSM, neni 10(3(i))).

## 2 Master Planit i Gazit për Shqipërinë

### 2.1.1 Konteksti i Hartimit të Master Planit të Gazit

Prodhimi i gazit në Shqipëri ka rënë nga 1 miliard meter kub (mmk) në vitin 1982 në 0.01 mmk në vitet e fundit. Shqipëria nuk është lidhur me sistemin ndërkombëtar të transmetimit të gazit dhe ka një rrjet të izoluar shpërndarjeje. Sistemi egzistues i transmetimit dhe shpërndarjes së gazit është i vjetëruar, i reduktuar dhe i përqendruar në pjesën jugore të vendit, ku mbulon pjesërisht furnizimin e rafinerive të naftës në Ballsh dhe Fier nga vendburimet e Divjakës dhe Frakullës, si dhe nga gazi shoqëruar në vendburimet e naftës afër Ballshit. Rafineritë egzistuese të naftës, në Ballsh dhe Fier, me kapacitet total 1 Mt/vit, punojnë me 40-50% të kapacitetit të tyre. Industri të tjera të tilla si uzina e plehrave kimike në Fier, që ishte një konsumatore e madhe e gazit në vitet 70, janë mbyllur.

Gazifikimi i Shqipërisë dhe lidhja me rrjetin rajonal filloi me projektin TAP, i cili përbën edhe infrastrukturën kryesore furnizuese të gazit. Projekti IAP, i cili duhet të furnizohet me gaz nga TAP, përbën objektin e dytë të rëndësishëm në këtë fushë. Bazuar në kapacitetin transportues dhe vendndodhjen gjeografike të tij, IAP përbën shtyllën kryesore të rrjetit të transmetimit të gazit në Shqipëri.

Si pjesë e zhvillimit fillestar të një master plani të gazit, rrjeti i transmetimit të gazit në të gjithë Shqipërinë duhet zhvilluar për furnizimin e qendrave kryesore urbane e konsumatorëve kryesorë industrialë, si dhe për tu lidhur me vendet kufitare, në një mënyrë sa më ekonomike të mundshme, dhe me ndikim minimal në mjedis.

Koncepti i propozuar në MPG për Shqipërinë bazohet në eksperiencën e fituar nga projekti IAP dhe shfrytëzon në maksimum gjurmen e tij.

### 2.1.2 Qellimi i Hartimit të Master Planit të Gazit

Hartimi i Master Planit të Gazit për Shqipërinë synon:

1. Identifikimin e kërkesave dhe skenarët e mundshëm për furnizim me gaz;
2. Politikat e çmimeve, tarifat dhe strukturat legale rregullatore të gazit;
3. Promovimin e gazit natyror në Shqipëri;
4. Forcimin dhe permiresimin e kuadrit ligjor e institucional ne sektorin e gazit natyror;
5. Zhvillimin e njohurive ne fushen e gazit dhe aftësimin e kuadrove të MEI, OST-G, ERE; dhe
6. Zhvillimin e një plani të projekteve me përparësi, përfshirë analizën në nivel parafizibiliteti të projekteve të mundshme të infrastrukturës së

gazit, së bashku me strategjitë për tërheqjen e investimeve nga palët e interesuara, sidomos nga sektori privat.

Rezultatet e hartimit të projektit dhe përcaktimit të Projekteve Prioritare do të merren për bazë nga Qeveria Shqiptare dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare (BERZH-i dhe institucionet e tjera që do të përcaktohen më vonë), për të marrë vendimet e duhura për investime në infrastrukturën e gazit.

### 2.1.3 Paraqitje e përmbledhur e MPG

MPG për Shqipërinë synon përdorimin e gazit në industri, transport, përdorim shtëpiak, etj. Burimi parësor i furnizimit me gaz do të jetë gazsjellësi TAP, e më pas IAP e rezervat e tjera të mundshme në shkallë vendi. Një nga alternativat e MPG do të jetë edhe parashikimi nëse projekti IAP nuk do të zbatohet. MPG do të marrë në konsideratë edhe mundësinë e lidhjes së Kosovës e Maqedonisë me rrjetin shqiptar të transmetimit të gazit. Përveç kësaj, do të merret në shqyrtim edhe mundësia e stokimit nëntokësor të gazit në Dumre e Divjakë.

Qendrat e banuara dhe korridoret e propozuara të gazit jepen në Figure 2—1 më poshtë. Vlen të theksohet se nga Fieri në lumin Buna korridori i propozuar i transmetimit të gazit ndjek rrugën e IAP, i cili përbën linjën kryesore të sistemit të transmetimit të gazit në Shqipëri.

### 2.1.4 Zona e prekur nga MPG

Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat e MPG për Shqipërinë, është përcaktuar shtrirja gjeografike e zonës së projektit, e cila varet nga: pozicioni i linjave të transmetimit të gazit (TAP dhe IAP); rrjeti ekzistues i gazit; konsumatorët industrialë ekzistues dhe të mundshëm; vendet e planifikuara natyrore për magazinimin nëntokësor të gazit (Divjaka dhe Dumrea - Figure 2—2); si dhe lidhjet e mundshme me vendet kufitare me Shqipërinë.






Figure 2—1\_ Qëndrat urbane dhe korridorret e mundshme të gazit sipas MPG



Figure 2—2\_ Paraqitje skematike e pozicionit të tubacioneve egzistuese të gazit e naftës si dhe vendeve të mundshme nëntokësore të gazit

## 3 Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Master Plani i Gazit për Shqipërinë

### 3.1 Përse duhet kryer VSM mbi MPG

VSM është një mjet që lejon shmangjen e ndikimeve të dëmshme në mjedis që në fazën e hartimit të MPG. Pra, në vend që, gjatë zbatimit të këtij plani të merren masa për të zbutur ndikimet negative në mjedis, këto ndikime mund të mënjanohen plotësisht që në fazën e hartimit të tij. Ky është edhe qëllimi kryesor i VSM.

Në mënyrë të përmbledhur, objektivat kryesore strategjike të VSM, janë<sup>1</sup>:

1. Të ndihmojë në integrimin e mjedisit (përfshirë atë biofizik, social, institucional dhe ekonomik) në zhvillimin e qëndrueshëm, duke mundësuar propozime për ndryshime/përshtatje të MPG;
2. Të ndihmojë vendimmarrjen nëpërmjet diskutimit të mundësive dhe rreziqeve të alternativave të MPG, duke synuar që problemet mjedisore të shmangen dhe, kur është e mundur, të arihet në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në zonën e zhvillimit të këtij Plani; si dhe
3. Krijimin e një mentaliteti strategjik në vendimmarrje, i tillë që perkrah dialogun dhe bashkëpunimin institucional dhe shmang konfliktet e mundshme.

Procesi i VSM ndihmon edhe në realizimin e aspekteve të tjera pozitive, përfshirë:

- *Shmangia e degradimit mjedisor*: Duke identifikuar çështjet dhe ndikimet mjedisore që në fillim të përgatitjes së Planit, VSM ndihmon zhvilluesin e planit të shmangë efektet e mundshme negative në mjedisin pritës;
- *Identifikimi i alternativa reale dhe të arsyeshme të P/P*: VSM ndihmon zhvilluesin e planit të marrë në konsideratë alternativa të arsyeshme, duke përfshirë aspektet mjedisore, të cilat, në mungesë të kryerjes së procesit të VSM, mund të liheshin mënjane;
- *Përgatitja e arsyetuar e P/P*: Duke siguruar informacion mbi mjedisin pritës dhe mbi efektet e mundshme mjedisore, VSM ndihmon zhvilluesin e planit të përgatisë një Plan të bazuar. VSM mund të ndihmojë në përmirësimin e P/P që në fillim të hartimit të tij;
- *Ulja e kostove afatgjata*: Shmangia e ndikimeve negative mjedisore minimizon nevojën dhe kostot për ndërhyrje të nevojshme korrigjuese. Ndërsa VNM synon zbutjen e efekteve të mundshme mjedisore të një

<sup>1</sup> Better Practice Guide on SEA. Maria Rosario Partidal

[http://ec.europa.eu/environment/eia/pdf/2012%20SEA\\_Guidance\\_Portugal.pdf](http://ec.europa.eu/environment/eia/pdf/2012%20SEA_Guidance_Portugal.pdf)

projekti, VSM synon shmangien e tyre në fazën e hartimit të projektit. Pra, VSM ndihmon edhe në thjeshtimin e VNM dhe uljen e kostos së proceseve të VNM, në projekte të ndryshme, në të njëjtën zonë gjeografike;

- *Përmirësimi i komunikimit dhe transparencës në realizimin e MPG:* Raportet e VSM dhe fazat e komunikimit të këtij procesi përmirësojnë transparencën në vendimmarrje, si dhe në të kuptuarit publik mbi efektet mjedisore dhe sociale që mund të dalin nga fazat e zhvillimit të P/P;
- *Reduktimi i kundërshtive/ankesave ndaj MPG:* Vendimmarrësit kryesorë, grupet e interesuara dhe /ose publiku që mund të kenë kundërshti ndaj P/P, do të kenë më pak ankesa, kur e kuptojnë se ndikimet e dëmshme janë shmangur/reduktuar në minimum gjatë hartimit të P/ P;
- *Lehtësimi i miratimit të P/P nga organet përkatëse:* Nëse janë shmangur / reduktuar në minimum ndikimet negative, lehtësohet edhe vendimi për miratimin e MPG, pa patur nevojë të anulojë apo rishikojë atë.

### 3.2 Cështjet që duhen njohur për të arritur synimet e VSM mbi MPG

Për të arritur objektivat e mësipërme, autorët e VSM duhet të njohin thelbin e çështjeve të mëposhtme:

- Qëllimin, objektivat, dhe përbërësit e aktivitetet kryesorë të MPG;
- Kushtet mjedisore (duke përfshirë edhe problemet mjedisore) në zonën ku do shtrihen elementët përbërës dhe aktivitetet e MPG;
- Planet/programet e tjera, në të njëjtën zonë gjeografike, ose në të njëjtin sektor në nivele të ndryshme (p.sh.sektori i energjisë: gazi dhe energjia elektike), në mënyrë që të shmangen ndikimet negative kumulative mjedisore, dhe, kur është e mundur, të përforcohen ndikimet pozitive;
- Legjislacionin mjedisor kombëtar dhe të BE-së, si dhe udhëzuesit dhe përvojën e mirë ndërkombëtare mbi VSM; si dhe
- Konsultimin ligjor dhe jo ligjor me vendimmarrësit kryesorë dhe aktorë të tjerë të lidhur me MPG, si dhe me grupet e interesuara dhe publikun.

### 3.3 Baza ligjore ku mbështetet VSM mbi MPG

***Detyrimi për kryrjen e procesit të VSM mbi MPG përcaktohet nga:***

- Ligji 91/2013 mbi VSM, dhe VKM nr. 507/2015;
- Direktiva e BE-së mbi VSM

***Procedura e kryerjes së procesit të VSM mbi MPG, bazohet në:***

- Ligji shqiptar 91/2013 mbi VSM;
- Direktiva e BE-së mbi VSM

***Detyrimi për konsultim dhe procedura e procesit të konsultimit në kuadër të VSM mbi MPG, mbështeten në:***

- Ligji 91/2013 mbi VSM;
- VKM nr. 219/2015 (konsultimet në shkallë vendi);
- VKM nr. 620/2015 (konsultimet në kuadrin ndërkufitar); dhe
- Direktiva e BE-së mbi VSM

***Standarte të tjera ndërkombëtare ku mbështetet detyrimi për VSM mbi MPG dhe detyrimet kryesore që duhet të përmbushë VSM:***

Standartet e institucioneve kryesore financuese nderkombetarë, të marra parasysh në procesin e VSM mbi MPG janë ato të BERZH dhe BEI. BERZH është institucioni financiar i interesuar të financojë zbatimin e MPG, ndërsa BEI është autoriteti menaxhues i grantit të dhënë nga ËBIF për realizimin e studimit të MPG, pjesë e të cilit është edhe përgatitja e Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

## **3.4 Metodologjia e procesit të VSM për MPG**

### **3.4.1 Qasja e ndjekur në rastin e VSM për MPG**

Qasja e përgjithshme e ndjekur në rastin e kryerjes së procesit të VSM për MPG, është mbështetur në parimet e mëposhtme:

- Të jetë në përputhje me Ligjin Shqiptar për VSM dhe procedurat e Direktivës së VSM-së (nenet 2-12);
- Të bazohet në informacionet apo të dhënat e kërkuara në Ligjin Shqiptar për VSM-në (Shtojca I) dhe Direktivës së VSM-së (Shtojca I); dhe
- Të plotësojë qëllimin e përgjithshëm të Direktivës së VSM-së për integrimin e praktikave më të mira në metodologjinë e VSM-së (neni 12)

Ndërsa metodologjia ekonsultimit dhe kërkesat përkatëse ligjore janë bazuar tërësisht në legjislacionin shqiptar, për shkak se dispozitat e VKM-ve 219/2015 dhe 620/2015 mbi këtë çështje janë shteruese dhe përfshijnë edhe standartet e BE, BERZH dhe BEI.

### 3.4.2 Fazat e VSM për MPG

Per te kuptuar qellimin e raportit paraprak te VSM-së, eshte e nevojshme te kemi parasysh procesin e VSM e fazave te tij, si dhe rendesine e raportit paraprak ne kuader te ketij procesi.

Spas nenit 7 të ligjit mbi VSM, ky proces duhet te ndjekë, fazat e mëposhtme:

1. konsultimi me grupet e interesit për çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së;
2. hartimi i raportit paraprak te VSM dhe konsultimi i tij me grupet e interesit dhe publikun;
3. hartimi i raportit përfundimtar të VSM;
4. shqyrtimi i propozimit dhe deklarata e ministrit;
5. vendimi i autoritetit miratues;
6. monitorimi dhe raportimi i pasojave në mjedis të planit apo programit.

Faza e pare: konsultimi me grupet e interesit për çështjet që do të trajtohen në raportin e VSM-së, u zhvillua ne shkurt 2016. Konsultimi u krye ne mjediset e MEI, pas daljes se njoftimit perkatës në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit, në përputhje me nenin 8 të ligjit mbi VSM.

Faza e dyte: hartimi i raportit paraprak te VSM dhe konsultimi i ketij raporti me grupet e interesit dhe publikun, përbën edhe objektin e këtij raporti. Ky raport paraprak do ti nënshtrohet, më pas një faze konsultimi me publikun, në përfundim të së cilës do të përgatit raporti përfundimtar paraprak mbi VSM.

### 3.4.3 Qëllimi i përgatitjes së raportit paraprak dhe konsultimit të tij

Roli i fazes paraprake qëndron në faktin se gjatë saj ndërtohet një kuadër mjedisor që synon shmangjen e ndikimeve negative, ne vend të korrigjimit apo zbutjes së tyre në fazat e mëvonshme. Për të arritur këtë synim, faza paraprake duhet te përqëndrohet ne çështjet kyce mjedisore duke lënë mënjanë ndikimet e parëndësishme te planit/programit. Në këtë drejtim ndihmon edhe konsultimi i draftit të raportit paraprak me vendimmarresit kryesore të përcaktuar me ligj.

Cështjet mjedisore të marra në konsideratë në këtë fazë të VSM kanë të bëjnë kryesisht mjedisin biofizik (ajri, faktorët klimatikë, toka, uji, flora, fauna, zonat e mbrojtura, etj), peizazhin, infrastrukturën, popullsinë, shëndetin e njeriut, trashëgiminë kulturore, etj, si dhe marrëdhëniet midis këtyre faktorëve

### 3.4.4 Detyrat e fazës paraprake të VSM mbi MPG

Cdo fazë procedurale e procesit të VSM-së përfshin disa "detyra", dhe për secilën prej tyre një qasje të veçantë është përcaktuar për të marrë rezultatin e pritur. Numri, natyra, dhe thellësia e përpunimit të këtyre detyrave të varet nga:

- qëllimi dhe objektivat e planit;
- tiparet ekzistuese dhe të pritshme mjedisore në zonën e projektit;
- ndërveprimet e MPG-së me plane/programe të tjera;
- mënyra se si ekipi i VSM-së merr parasysh udhëzimet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare për VSM-në;
- kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe të BE-së;
- standardet përkatëse të IFN-ve për VSM-në;
- mendimet / sugjerimet e palëve të interesuara dhe atyre statutore.

Mbi bazën e faktorëve të mësipërm, u përcaktuan detyrat konkrete të raportit paraprak të VSM-së mbi MPG, si dhe qëllimet e lidhura me to, të cilat jepen më poshtë:

- A1: Përcaktimi i elementeve kryesore të MPG
- A2: Mbledhja e informacionit mbi zonën e projektit;
- A3: Probleme Mjedisore ne Zonen e Projektit;
- A4: Përmbledhja e planeve/programeve te tjera;
- A5: Përcaktimi i çështjeve kryesore mjedisore;
- A6: Pëpilimi i listës së te konsultuarve dhe lidhja e tyre me MPG;
- B1: Zhvillimi e objektivave dhe treguesve mjedisore;
- B2: Testimi i objektivave te MPG;
- B3: Identifikimi dhe vlerësimi i alternativave të MPG;
- B 4: Identifikimi, perzgjedhja dhe vlerësimi i çështjeve mjedisore;
- B5: Vlerësimi i ndikimeve indirekte, sinergjike, dhe kumulative;
- B6: Percaktimi i Ceshtjeve te Monitorimit;

- B7: Procesi i konsultimit të draft raportit paraprak;
- B8: Çështjet që do të trajtohen në raportin paraprak të VSM-së

### 3.4.5 Përcaktimi i çështjeve mjedisore the objektivave përkatëse te VSM mbi MPG

Në përfundim të përcaktimit të detyrave konkrete të fazës paraprake të VSM mbi MPG, u përcaktuan edhe çështjet kryesore mjedisore që do të vlerësohen gjatë konsultimit të detyrueshëm të draftit të raportit paraprak. Këto çështje, si dhe objektivave kryesore mjedisore që duhet të zgjidhen në kuadër të raportit përfundimtar të VSM jepen në tabelën e mëposhtme:

Table 3-1\_ Çështjet e VSM-së dhe objektivat mjedisore në rastin e MPG për Shqipërinë

No	Çështjet e VSM-së	Objektivi mjedisor i VSM-së
1	Ajri	Ruajta e përmirësimi i efekteve mbi cilësinë e ajrit
2	Ndryshimet i klimatike	Ruajta dhe përmirësimi i efekteve mbi ndryshimet klimatike
3	Gjeologjia dhe mbulesa e tokës	Ruajta dhe përmirësimi i efekteve në aspektet gjeologjike dhe mbulesës së tokës
4	Burimet ujore	Ruajta e përmirësimi i efekteve mbi burimet ujore
5	Biodiversiteti dhe Zonat e Mbrojtura	Ruajta dhe përmirësimi i efekteve mbi Biodiversitetin dhe zonat e mbrojtura
6	Përdorimi i tokës	Ruajta dhe përmirësimi i efekteve mbi përdorimin e tokës
7	Infrastruktura	Ruajta e përmirësimi i efekteve në infrastrukturë
8	Peizazhi	Ruajta dhe përmirësimi i efekteve në peizazhin
9	Çështjet sociale	Mbrojtja dhe përmirësimi i përfitimeve sociale
10	Shëndeti i popullsisë	Mbrojtja dhe përmirësimi gjendjes shëndetësore
11	Trashëgimia kulturore	Ruajta dhe përmirësimi i efekteve mbi Trashëgiminë Kulturore
12	Mbetjet dhe përdorimi i burimeve natyrore	Ripërdorimi, përpunimi dhe riciklimi i mbeturinave

### 3.4.6 Testimi i objektivave te VSM dhe atyre të MPG dhe vlerësimi I alternativave të MPG.

Objektivat e VSM dhe ato të MPG do të analizohen në mënyrë që, në se është e nevojshme, të bëhen ndryshimet e duhura në MPG për të mos patur ndikime të ndjeshme në mjedis.

Ky testim do të bëhet për cdo alternativë të MPG, në mënyrë që, Brenda kuadrit të arritjes se synimit të MPG, të përzgjidhet alternative më miqesore me mjedisin



Alternativat e propozuara në lidhje me MPG jepen në tabelën e mëposhtme;

Table 3-2\_ Alternativat e propozuara në lidhje me MPG

No	Alternativat i MPG-së	Koment
0	Alternativa "0" or "të bërit asgjë"	
1	a- furnizimi me gaz për 85 komuna në Shqipëri; b-Ndërtimi i IAP me diametër të caktuar në drejtim të Malit të Zi dhe Kroacisë; c-Furnizimi i Kosovës nga drejtimi i Kukësit; d-furnizimit i IRJM nga drejtimi i Prrenjasit	-IAP do të zbatohet; -GMP përfshin Shqipërinë, Kosovën dhe IRJM
2	a- furnizimi me gaz për 85 komuna në Shqipëri; b-Ndërtimi i IAP me diametër të caktuar në drejtim të Malit të Zi dhe Kroacisë	- IAP do të zbatohet;; -GMP përfshin vetëm Shqipërinë
3	a- furnizimi me gaz për 85 komuna në Shqipëri; c-Furnizimi i Kosovës nga drejtimi i Kukësit; d-furnizimit i IRJM nga drejtimi i Prrenjasit	-IAP nuk zbatohet; -GMP përfshin Shqipërinë, Kosovën dhe IRJM
4	a- furnizimi me gaz për 85 komuna në Shqipëri;	-IAP nuk zbatohet; -GMP përfshin vetëm Shqipërinë

Testimi i objektivave të VSM me ato të cdo alternative të MPG, do të bëhet sipas tabelës së mëposhtme.

Table 3-3\_\_ Testimi i përputhshmërisë të objektivave të VSM-së dhe MPG

Objektivi VSM	Objektivat e MPG					
	Objektivi 1	Objektivi 2	Objektivi 3	Objektivi 4	Objektivi 5	Objektivi 6
Objektivi 1	+	x	+	+	-	-
Objektivi 2	+	+	+	+		?
Objektivi 3	+	?	+			+
Objektivi 4	0	-	-			+
Objektivi 5	-	+	+x	0		+

+: I pajtueshëm; -: I Papajtueshëm; + -: Pjesërisht i pajtueshëm; ?: Marrëdhënia nuk është e qartë; 0: nuk ka lidhje

### 3.4.7 Konsultimi i draft raportit paraprak të VSM

Draft raporti paraprak I VSM (ky dokument) do ti nënshtrohet një konsultimi të detyrueshëm, bazuar ne ligjin mbi VSM dhe VKM-të 219/2105 dhe 620/2015. Palët e konsultuara përcaktohen nga ligji mbi VSM.

Palët e konsultuara mund ti përgjigjen pyetjeve të hartuara në fund të secilës detyrë (detyrat A dhe B të të VSM – shih 3.4.4), si dhe të japin mendimin e tyre edhe për çështje që ata mendojnë se nuk janë trajtuar mjaftueshëm në këtë draft raport paraprak, apo nuk janë trajtuar fare. Këto mendime/përfundime do të shërbejnë për të përmirësuar këtë raport paraprak, mbi

bazën e të cilit do të përgatitet draft raporti përfundimtar i VSM. Konsultimet dhe rezultatet e tyre do të përshkruhen në një dokument/shtojcë të veçantë.

### 3.4.8 Hartimi i draft raportit përfundimtar të VSM

Raporti përfundimtar i VSM-së përgatitet dhe paraqitet si dokument i veçantë, ku përveç çështjeve të trajtuara në raportin paraparak, pasqyron edhe rezultatet e konsultimeve të raportit paraparak të VSM-së me grupet e interesit, publikun dhe shtetin fqinj, në rast të një procesi ndërkufitar konsultimesh (Ligji mbi VSM, Neni 11(1)). Ndërsa Neni 11(2) i këtij ligji kërkon që në raportin përfundimtar të VSM të argumentohet se si janë marrë në konsideratë kërkesat dhe sugjerimet gjatë procesit të konsultimit.

Bazuar në ligjin mbi VSM, përfundimet e raportin paraparak, si dhe përvojën më të mirë ndërkombëtare, draft struktura e Raportit Përfundimtar të VSM duhet të përfshijë:

- Përmbledhje jo-teknike
- Hyrje
- Procesi i VSM dhe Raporti Përfundimtar i VSM
- Kuadri ligjor
- Rezultatet e konsultimeve
- Metodologjia e procesit të VSM
- Objektivat e VSM dhe detyrat përkatëse
- Objektivat e MPG
- Plane dhe programe të tjera, me lidhje me MPG, si dhe objektivat e tyre
- Përshkrimi i mjedisit ekzistues
- Probleme Mjedisore në zonën e projektit
- Krahasimi i objektivave të MPG me ato të VSM
- Vlerësimi i ndikimeve të MPG
- Krahasimi i alternativave të MPG
- Konsultimi ligjor i draftit të Raportin Përfundimtar të VSM
- Përfshirja e rezultateve të konsultimeve në raportin përfundimtar të VSM

### 3.4.9 Planifikimi i konsultimeve mbi draft raportin përfundimtar të VSM dhe draft raportin e MPG

Sipas planit të punë për VSM mbi MPG, datat / periudhat e parashikuara për kryerjen pjesën se mbetur të këtij procesi do të jenë si më poshtë:

- Draft raporti përfundimtar i VSM-së duhet të dorëzohet në gusht 2016;
- Konsultimi publike mbi draft Raportin përfundimtar të VSM-së, përfshirë kontekstin ndërkufitar, propozohet të kryhet nga 01 shtatori 2016 deri në 31 tetor 2016;
- Rezultatet e këtij konsultimi do të përfshihen në Raportin përfundimtar të VSM-së, version final i të cilit duhet të dorëzohet më 15 dhjetor 2016;

- Vec kësaj, ekipi i hartimit të MPG duhet të paraqesë një material ku të pasqyrohet se si janë marrë në konsideratë rekomandimet e VSM-së dhe rezultatet e konsultimeve, në variantin përfundimtar të MPG (Ligji mbi VSM, Neni 13).

## 4 Literatura

- Ligji nr 91/2013: “Mbi Vleresimin Strategjik Mjedisor”;
  - Ligji nr 10440/2011: “Mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”;
  - VKM nr 219/2015: “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”;
  - VKM nr 620/2015: “Për miratimin e rregullave, përgjegjëse dhe procedurave të detajuara për vlerësimin strategjik mjedisor në kontekstin ndërkuftar”;
  - VKM nr.507, datë 10.06.2015: “Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”;
  - Direktiva 2001/42/KE, datë 27.06.2001: “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara” – (Direktiva mbi VSM);
  - Direktiva 2011/92/KE, rishikuar me Direktiven 2014/52, date 12.03 2014: “Mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” – (Direktiva mbi VNM);
  - Direktiva 92/43: “Mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe faunes e flores se eger” – (Direktiva mbi habitatet);
  - Environmental and Social Policy, EBRD, May 2014
- Politikat Mjedisore dhe Sociale, BERZH, Maj 2014;
- Statement of Environmental & Social Principles and Standards, EIB, 2009
- Deklarate mbi Parimet dhe Standartet Mjedisore e Sociale, BEI, 2009;
- Environmental and Social Handbook, 2013
- Manual Mjedisor e Social, BEI, 2013;
- Albania GMP and PIP projects\_ ToRs, 2015
- MPG dhe PIP per Gazin ne Shqiperi\_ Termat e References, 2015;
- Albania GMP & PIP projects\_ Inception report, COWI-IPF, Nov.2015
- MPG dhe PIP per Gazin ne Shqiperi \_Raporti i planit te punes (Inception report), COWI-IPF, Nentor 2015;
- Albania GMP & PIP projects\_ SEA Proposal, COWI-IPF, Nov.2015
- MPG dhe PIP per Gazin ne Shqiperi \_Propozimi per VSM, COWI-IPF, Nentor 2015
- Albanian GMP & PIP projects\_ SEA screening report, COWI-IPF, Jan.2016
  - (MPG dhe PIP per Gazin ne Shqiperi \_Raport mbi qendrimin ndaj nevojës per VSM, COWI-IPF, Jan. 2013)
  - Better Practice Guide on SEA; Maria Rosario Partidal. Lisbon, 2012

[http://ec.europa.eu/environment/eia/pdf/2012%20SEA\\_Guidance\\_Portugal.pdf](http://ec.europa.eu/environment/eia/pdf/2012%20SEA_Guidance_Portugal.pdf)

- A Practical Guide to the Strategic Environmental Assessment Directive, London, 2005

[www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/7657/practicalguidesea.pdf](http://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/7657/practicalguidesea.pdf)

- Strategic Environmental Assessment Guidance. Scottish Government, 2013

<http://www.gov.scot/Resource/0043/00432344.pdf>

- Development of SEA Methodologies for P/Ps in Ireland. Scott P. & Marsden P. Irish Environmental Protection Agency, 2003

[https://www.epa.ie/pubs/advice/ea/EPA\\_development\\_methodology\\_SEA\\_synthesis\\_report.pdf](https://www.epa.ie/pubs/advice/ea/EPA_development_methodology_SEA_synthesis_report.pdf)

- Guidelines for the Assessment of Indirect and Cumulative Impacts as well as Impact Interactions; European Commission, 1999

<http://ec.europa.eu/environment/archives/eia/eia-studies-and-reports/pdf/guidel.pdf>

- EC Guide on SEA Directive. European Commission, Sept. 2003

[http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/eia/documents/EC\\_SEA\\_Guidance/ec\\_030923\\_sea\\_guidance\\_en.pdf](http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/eia/documents/EC_SEA_Guidance/ec_030923_sea_guidance_en.pdf)

- Assessment of the Effects of Certain Plans and Programmes on the Environment. Guidelines for Regional Authorities and Planning Authorities. Government of Ireland. November 2004

<http://www.environ.ie/sites/default/files/migrated-files/en/Publications/DevelopmentandHousing/Planning/FileDownload%2C1616%2Cen.pdf>